



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA KAMEZ

RELACION TEKNIK

PER PROJEKTIN E ZBATIMIT

Vizime Rrugesh
Sinjalistika Horizontale dhe Vertikale
Bashkia Kamez

Punoi:

Ing. Hajredin MURGU
- Ing. Elmas MURATI

Drejtori i P.K.ZH.T-se

Ark. Arber TOLA

MIRATOI

Xhelal MZIU

K R Y E T A R

OBJEKTI: Vizime Rrugesh Sinjalistika Horizontale dhe Vertikale , Bashkia Kamez

- A . Vizime rrugesh T=12cm me boje bikomponente
- B. F.V. Tabela te Ndryshme Rrugore 60 cm
- C. Vizime Gjatesore e Anesore Rrugesh t=12 cm me boje Akrilike
- D. Vizime me Boje Bikomponente (Kalim Kembesore)
- 4. Vizimi Njesise per Njesine Administrative Paskuqan dhe Bashkia Kamez

PËRMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK

1. TË PËRGJITHSHME

- 1.1- Hyrje
- 1.2- Pozicioni i objektit
- 1.3- Gjendja Ekzistuese
- 1.4- Kushtet Klimatike te Zones
- 1.5- Rilevimi Topografik
- 1.6- Studimi Gjeologjik

2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

a.Vizime Rrugesh Sinjalistika Horizontale dhe Vertikale , Bashkia Kamez

- A . Vizime rrugesh T=12 cm me boje bikomponente 26500 ml
- B. F.V. Tabela te Ndryshme Rrugore 60 cm cope 183
- C. Vizime Gjatesore e Anesore Rrugesh t=12 cm me boje Akrilike 28501 ml
- D. Vizime me Boje Bikomponente (Kalim Kembesore) 1700 m2
- E. Vizimi Njesise per Njesine Administrative Paskuqan dhe Bashkia Kamez

3. PREVENTIVI I PUNIMEVE

a.Vizime Rrugesh Sinjalistika Horizontale dhe Vertikale , Bashkia Kamez

- A . Vizime rrugesh T=12 cm me boje bikomponente 26500 ml
- B. F.V. Tabela te Ndryshme Rrugore 60 cm cope 183
- C. Vizime Gjatesore e Anesore Rrugesh t=12 cm me boje Akrilike 28501 ml
- D. Vizime me Boje Bikomponente (Kalim Kembesore) 1700 m2
- E. Vizimi Njesise per Njesine Administrative Paskuqan dhe Bashkia Kamez

1. PERMBAJTJA E PROJEKT-ZBATIMIT

1) TE PERGJITHSHME

1.1-Hyrje

Bashkia Kamez me fondet e vena ne dispozicion do te realizoje projektin e zbatimit per objektin : *a.Vizime Rrugesh Sinjalistika Horizontale dhe Vertikale , Bashkia Kamez*

- A . Vizime rrugesh T=12 cm me boje bikomponente 26500 ml
- B. F.V. Tabela te Ndryshme Rrugore 60 cm cope 183
- C. Vizime Gjatesore e Anesore Rrugesh t=12 cm me boje Akrilike 28501 ml
- D. Vizime me Boje Bikomponente (Kalim Kembesore) 1700 m2
- E. Vizimi Njesise per Njesine Administrative Paskuqan dhe Bashkia Kamez

1.2-Pozicioni gjeografik i objektit

Zona që merret në studim gjëndet në Laknas (Kamez dhe Njesia Administrative Paskuqan)

Ñ Kamza është një qytet që shtrihet në kufijtë veriorë të qytetit të Tiranës, që është rritur me ritme të jashtëzakonshme në dhjetëvjeçarin e fundit dhe pritet të vazhdojë rritjen demografike me ritme të konsiderueshme në 20 vitet e ardhshme.

Ñ Zona që trajtohet në këtë projekt përfaqëson një terren me pjerresiri të bute në drejtim të veriut - jugut e cila ndodhet pranë lumit të Tiranës. Kjo përfaqëson një zonë urbane relativisht të dendur veçanërisht, me ndërtime 1-5 kate .

1.3 -Gjendja ekzistuese

Gjendja aktuale e objektit paraqitet:

a. Vizime Rrugësh Sinjalistika Horizontale dhe Vertikale , Bashkia Kamez

- A . Vizime rrugësh T=12 cm me boje bikomponente 26500 ml
- B. F.V. Tabela të Ndryshme Rrugore 60 cm cope 183
- C. Vizime Gjatesore e Anesore Rrugësh t=12 cm me boje Akrilike 28501 ml
- D. Vizime me Boje Bikomponente (Kalim Kembësore) 1700 m²
- E. Vizimi Njesise për Njesine Administrative Paskuqan dhe Bashkia Kamez



është një rrugë që duhet të bëhet me standarte .

Trotuaret janë të demtuar


✚ Kjo Zona ka nevojë për vizime dhe tabela sinjalistike

✚ TË PËRGJITHSHME

- ✚ • Sinjalistika horizontale dhe vertikale janë mjete që synojnë disiplinimin e qarkullimit të mjeteve dhe këmbësorëve, sikurse orientim, siguri dhe komoditet sipas standardeve bashkëkohore të përdoruesve të rrugës. Hartimi dhe aplikimi i projekteve për

kompletimin e Qytetit me sinjalistikën horizontale dhe vertikale, si dy nga komponentët kryesorë të sigurisë rrugore, japin një impact pozitiv në rregullimin e raportit këmbësor/drejtues mjeti, ku vërehet një tendencë në rritje për respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor.

Nisur nga fakti se për të garantuar një shikueshmëri të lartë dhe qëndrueshmëri në materialet përbërëse të sistemit është e nevojshme një rivendosje/plotesim i këtyre sinjaleve. Ky projekt parashikon aplikimin e sinjalistikës në rreth 12 Rruget Kryesore te Qytetit Kamez dhe Njesise Paskuqan 6 Rruge



1.4 - Kushtet Klimatike te Zones

Zona dallohet per dimer te bute me karakteristika te theksuara mesdhetare dhe vetem ne raste te rralla ashpersia e dimrit eshte e ndjeshme .

Si gjithë zona mesdhetare, ne pergjithesi ka nje sasi te konsiderueshme kohe me diell. Kjo arrin ne 2560 ore ne vit, me maksimum ne muajin Korrik me 360 ore dhe minimum 100 ore ne Dhjetor .

Presioni atmosferik sipas te dhenave shume vjeçare leviz nga 752-753 milimetra, e barabarte kjo me 1002.6-100.9 milibar.

Vlerat e temperatures se ajrit ne pergjithesi jane te qendrueshme .

Periudha me temperatura mesatare $> 7^{\circ}\text{C}$ zgjat afersisht 10 muaj.

Kjo zone perfshihet ne zonen klimaterike mesdhetare fushore qendrore. Temperatura mesatare vjetore leviz ne $15-16^{\circ}\text{C}$. Temperatura maksimale eshte regjistruar ne date 13.07.1973 me 43°C , ndersa temperatura minimale eshte regjistruar ne date 15.01.1968 me -14.4°C .

Reshjet, kryesisht në formën e shiut, janë përgjithësisht të dëndura gjatë vitit . Periudha e ngricave është kryesisht në muajt dhjetor-shkurt . Periudha e ngricave është kryesisht në muajt dhjetor-shkurt . Erërat që fryjnë nuk i kalojnë shpejtësitë 30-50 km/ore . Ujrat nentokesore jane ne kete zone me nivel statik nen thellesine 2 m ne kete aspekt ujrat nentokesore nuk kane ndonje ndikim direkt ne parametrat gjeoteknik te bazes se rrugeve deri ne thellesine 1m. Keto vleresime jane thelbesore per çdo projekt ndertimor dhe hidroteknik

Gjurma e rrugeve

Bashkia Kamez me fondet e vena ne dispozicion ka realizuar projektin e zbatimit per objektin :

- A . Vizime rruges T=12 cm me boje bikomponente 26500 ml
- B. F.V. Tabela te Ndryshme Rrugore 60 cm cope 183
- C. Vizime Gjatesore e Anesore Rrugesh t=12 cm me boje Akrilike 28501 ml
- D. Vizime me Boje Bikomponente (Kalim Kembesore) 1700 m²
- E. Vizimi Njesise per Njesine Administrative Paskuqan dhe Bashkia Kamez

2.1 PERSHKRIMI I RRUGEVE

NORMAT TEKNIKE TË SINJALEVE VERTIKALE

Karakteristikat teknike e cilësore të sinjaleve vertikale.

Prodhuesit e sinjaleve rrugore (tabelave dhe mbajtësve të tyre) duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Çdo prodhim i furnizuar duhet të jetë në kushte shumë të mira ambalazhimi dhe konservimi dhe në afatin e garancisë dhe të kohëzgjatjes.
- Të gjithë sinjalet duhet të jenë rigorozisht në përputhje me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë aprovuar nga Kuvendi Popullor me ligj nr. 8378, datë 22.07.1998 dhe Rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor me V.K.M. Nr.153, datë 07.04.2000. Përputhja konsiston në tipin, formën, dimensionin, përmasat, ngjyrat etj.

- Të gjitha shenjat rrugore të jenë në çdo pjesë të tyre me llamarinë hekuri të kuposur me bazë 1cm dhe spessori 1 mm(ose me llamarinë aliazhi të aluminit, jo më pak se 2.5-3mm).

Çdo sinjal duhet të jetë i përforcuar në të gjithë perimetrin e tij në një bordurë të kthyer në kënd. Të gjitha sinjalet në pjesën e pasme duhet të përmbajnë elementë konstruktivë, të cilët të bëjnë të mundur mbërthimin e saj në bishtin e tabelës. Shenjat me sipërfaqe më të madhe se 0.8 m², disqet dhe 8- këndëshat me diametër 90 cm, shenjat drejtuese etj, duhet të kenë elementë përforcues në pjesën e pasme të tyre për gjithë gjatësinë. Pjesa përforcuese duhet të jetë e përshtatshme për rrëshqitje dhe mbërthim në të tërë gjatësinë e stafave montuese në mbajtëse të shenjës.

- Për evitimin e vrimave në tabelë të gjitha shenjat duhet të pajisen në pjesën e pasme me profila përforcues të përshtatshme për t'u mbërthyer në anën e stafave, në tubat mbajtës me diametër 60 mm me spesor 2.3mm.
- Lidhjet me saldim dhe gjithë lidhjet e tjera ndërmjet tabelës dhe elementëve të tjerë struktural duhet të jenë bërë në mënyrë të tillë, t'i rezistojnë korozionit gjatë gjithë periudhës së jetëgjatësisë së tabelës.
- Përforcimet:

Çdo element duhet të ketë në pjesën e pasme profil formuar nga një kanal në të gjithë gjatësinë, që ka një funksion të dyfishtë: përforcimin e tabelës që jep mundësi për fiksion të lehtë dhe pozicionim korekt të tabelës në bishtin e saj.

Kompozimi (përbërja) e faqes së përparme të tabelës.

- Sipërfaqja e përparme e tabelës, mbasi është lyer me bojë opake të pjekur, mbi të aplikohet celuloidi reflektues sipas klasit të kërkuar. Klasi II për tabelat STOP, fig. 37 dhe klasi I për të tjerat).
- Përbërësi reflektues duhet të ketë karakteristikat fotometrike, kolometrike e teknologjike sipas kërkesave bashkangjitur në përputhje me kërkesat e RREGULLORES TE ZBATIMIT TE KODIT RRUGOR.

Pjesa e prapme e tabelës.

- Në pjesën e pasme të tabelës, ashtu siç është parashikuar në nenin 37 të V.K.M. nr.153, datë 7/4/2000, neni 75 paragrafi 7, duhet të shënohet enti pronar i rrugës, marka e firmës që ka prodhuar sinjalin, viti i prodhimit si dhe numuri i lejes që është i dhënë kësaj firme nga Ministria e Transportit për prodhimin e sinjaleve rrugore. Të gjithë shënimet e mësipërme duhet të jenë të përmbledhura në një sipërfaqe prej 20 cm².



- Çdo parti furnizimi duhet të jetë e shoqëruar me çertifikatë të provave të analizave. Të gjithë provat e analizat duhet të bëhen sipas metodologjisë së përshkruar në kampione çfarëdo.

Karakteristikat dhe cilësia e mbajtësve të shenjave rrugore.

- Bishtat e sinjaleve vertikale duhet të zgjidhen për të rezistuar erës me shpejtësi 150 km/orë që ekuivalentohet me një presion dinamik prej 140kg/m².
- Mbajtëset me tuba të shenjave vertikale duhet të jenë tuba çeliku me diametër 60 mm dhe me trashësi 2.3mm, të xinguar në të nxehtë sipas normave ASTM 123 dhe të palyera me ndonjë lloj boje.
- Tubat me diametër 60 mm do të përsosen për sinjalet trekëndore ose kuadratike me sipërfaqe deri 0.8 m² kurse për shenjat me sipërfaqe më të madhe, diametri i tubit rritet.
- Tubi në pjesën e sipërme duhet të jetë i mbyllur me një tapë plastike kurse në pjesën e poshtme të ketë vrima për kalimin me to, të shufrave prej hekuri për të evituar rrotullimin e tubit në bazament.
- Tubi duhet të fiksohet në tokë i mbështetur në një bazament betoni 50x50 cm.
- Stafat mbërthyesë të shenjës dhe bulona, dado, rondolet, duhet të jenë të xinguar në të nxehtë.
- Për tabela të mëdha diametri i tubit duhet të jetë 90 mm.
- Mbajtësit portale të shenjave të vendosura sipër rrugës duhet të jenë tubo çeliku të xinguar në të nxehtë sipas normave që theksuam më sipër.

Garancia e materialeve.


- Firma zbatuese duhet të garantojë materialet e furnizuara nga pikëpamja e cilësisë dhe e konsruksionit për të gjithë periudhën e përdorimit të tyre.
- Materialet e reflektueshme të përdorura në shenjat rrugore, duhet të lënë në përputhje me kërkesat e V.K.M.nr.153, datë7/4/2000dhe të plotësojnë edhe kushtet e mëposhme:
- Sinjalet me celuloid të klasit të I duhet të kenë vlerat fotometrike jo më pak se 50% të vlerës së mëparshme (burimit të dritës) mbas një peridhe prej 7 vjetësh.
- Sinjalet me celuloid të klasit të II duhet të kenë vlerat fotometrike jo më pak se 80% të vlerës së mëparshme (burimit të dritës) mbas një periudhe shërbimi prej 10 vjetësh.
- Kordinatat kolorimetrike duhet të jenë të përfshira në zonën e specifikuar, për çdo ngjyrë gjatë gjithë periudhës së jetëgjatësisë së shenjës, për të gjithë materialet reflektues të përdorur.

- Të gjithë materialet reflektues të përdorur duhet të mos dëmtohen gjatë gjithë periudhës së jetëgjatësisë për nga shkoputja nga sipërfaqja e tabelës, grisja dhe dëmtimi, ose dëmtime të tjera që mund të ndryshojnë informacionin e përshkruar në sinjal.
- Të gjitha lidhjet si saldime, lidhjet me bulona e stafe etj. duhet të garantojnë qëndrueshmërinë dhe të mos korodohen gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

Cilësia e fletës praparefleksive.

Dy klasat e praparefleksimit janë përshkruar më poshtë;

- Klasi i I reflektivitet i shkaktuar nga një shtresë sferëzash xhami të ngjitura në material transparent i ngjitur me të nxehtë ose të ftohtë.
- Klasi i II shkallë e lartë intesiteti, krahasuar me klasin e I, me një shtresë ajri ndërmjet sferëzave të xhamit dhe faqes së jashtme të fletës.
- Metoda e testimit përfshin testin mekanik, fotometrik dhe rezistencën në korozion.



- Të gjitha materialet e furnizuara duhet të kenë certifikatë testimi nga laboratore sipas normave të CE.
 - Fleta e testimit përbëhet nga një fletë alumini 2 mm trashësi ose mund të pritët nga një shënjë rrugore dhe të mbahet në një temperaturë 23+-2 gradë celsius dhe lagështi 50+-5% për 24 orë përpara testimit. Rezultati i testit bëhet mbas përfundimit të tre kampioneve në kushte të njëjta.
 - Këndet a dhe b jepen në tabelën e mëposhtme si dhe rezultatet minimale të shkallës së praparefleksimit në përputhje me normat Europiane “CIE Publication” no.54 Retrofleksion 1982 for lighting source A(Temperatura e ngjyrës 2856 gradë Kelvin duhet të shprehet në cd/lx*m2).
- ÇERTIFIKATAT E GARANCISË**

- Kontraktori duhet të paraqesë certifikatat e garancisë së mallit të furnizuar të cilat duhet të jenë:
- Çertifikata e materialit prapa reflektues të përdorur
- Çertifikata e xingimit të tubit
- Çertifikata e konstruksionit metalik të shënjës rrugore.

NORMAT TEKNIKE TË SINJALISTIKES HORIZONTALE

) Pershkrimi

Vijëzimi në rrugë konsiston në aplikimin e vijëzimeve rrugore në sipërfaqen e asfaltuar dhe të pastruar paraprakisht nga papastërtitë dhe pluhurat, në përputhje me vendndodhjen dhe dimesionet e paraqitura në vizatim ose nën drejtimin e inxhinjerit të ngarkuar. Referencat përkatëse ndodhen në Regulloren e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.

) **Makina/t per realizimin e vijezimit ne rruge (me pllaketë elektronike).**

Makina/t duhet të kryejë funksionet e vijezimit me bojë në të ftohtë me dy komponentë, e aplikueshme me sprucim. Makina duhet të sigurojë ecje të njëtrajtshme me sistem hidrostatik me shpejtësi vijezimi variabël me sistem hidraulik. Ajo duhet të realizojë punë me prerje të pastra dhe të njëtrajtshme sprucimi. Këta sprucatorë duhet të komandohen në mënyrë të tillë që të leshojnë dhe ndërpresin sprucimin në mënyrë manuale dhe automatike, sipas kërkesave. Makina duhet të realizojë vija me dimensione d=12-50 cm.



Karakteristikat e materialit per realizimin e vijeimit

J) Materialet

Lënda e parë që do të përdoret në vijëzimin e rrugëve duhet të jetë posaçërisht për të, të ketë sasinë e nevojshme të reflektivitetit dhe qëndrueshmeri. Të gjitha karakteristikat e mësipërme të jenë në përputhje me Standartin Europian ISO 9001; dhe UNE- EN 1436. Rregullat e përfshira në këto standarte mund të zëvendësohet nga të tjerët e të përdorur në ndonjë prej shteteve të tjera anëtare të Bashkimit Evropian, ose janë pjesë e Marrëveshjes mbi Zonën Ekonomike Evropiane, dhe në ato shtetet që kanë një marrëveshje shoqatë doganore me Bashkimin Evropian me kusht që të kenë të treguar specifikime identike teknike (UNE-EN 1790, UNE-EN 1871, UNE-EN 12802, UNE-EN 13197, UNE-EN 1423, UNE-EN 13459, UNE-EN ISO 2813, UNE 135204, UNE 135277). Furnitura e bojës së vijëzimit duhet të ketë certifikatë aprovimi, në të cilën të jenë testet laboratorike. Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatat e orgjinës së materialeve të përcaktuara në specifikimet teknike të mëposhtme si dhe mostrat e materialeve që do përdori.

Bojë plastike e ftohtë bikomponente e aplikushme me sprucim, me karakteristika qëndrueshmërie në një kohë më të gjatë dhe për ngarkesa të mëdha dhe të dendura të trafikut dhe me një qëndrueshmëri 3 000 000 deri në 4 000 000 shkelje automjetesh mbi material. Fusha e përdorimit do të jetë në vijat ndarëse të korsive, ndalimqëndrimit, shkrimeve dhe shigjetave të drejtimit.

Karakteristikat Fiziko-Kimike:

Rezistenca gjate përdorimit - 100 %

Rezistenca në ferkim SRT - >45

Shikueshmeria natën (RL) lx Tapet i paster - RI > 150 lx

Shikueshmeria ditën (Qd) lx Tapet i paster - RI > 160 lx

Aplikimi: Boja përpara përdorimit duhet të përziej mirë dhe kushtet atmosferike të jenë në një temperaturë mbi 5°C. Norma e harxhimit 1.4 – 2kg/m² (komponenti A+B+ mikrosfera xhami). Koha e tharjes <30 min. Kontraktori duhet të dorëzojë një sasi prej 1 kg bojë nga e cila do të përdoret së bashku me specifikimet teknike të fabrikës dhe normat e konsumimit

dhe garancine e jetëgjatësisë së vijës së shënuar. Ngjyra duhet të jete ngjyre e bardhe (ose e verdhe) puro. Ngjyra pas aplikimit duhet ti rezistojë kohës. (e that, lagësht dhe me shi)

Karakteristikat e Mikrosferave të Xhamit:


Indeksi thyes -- Klasi A

Maksimumi% e peshuar e rruazave -- Rruaza me diametër <1 mm -- Max.20%. Rezistenca ndaj ujit, acid klorhidrik, klorur kalciumi dhe sulfide natriumi -- E kalueshme

Substanca të rrezikshme -- Class 1 për As, Pb dhe Sb

Mikrosferat e Xhamit duhet të kenë performancë sipas standardit **EN 1423:2012 + AC:2013**

Boje bikomponente plastike në të ftohtë (paste) me karakteristika qëndrueshmërie në një kohë më të gjatë dhe për ngarkesa të mëdha dhe të dendura të trafikut dhe me një qëndrueshmëri 3 000 000 deri në 4 000 000 shkelje automjetesh mbi material. Fusha e përdorimit do të jetë në kalimet e këmbësorëve me fluks të madh lëvizjeje automjetesh dhe këmbësorësh.



Karakteristikat Fiziko-Kimike:

Rezistenca gjate perdorimit - 100 %

Rezistenca ne ferkim SRT - >45

Shikueshmeria naten RL (mcd.m-2lx-1) Tapet i paster - RI = 501

Shikueshmeria ditën Qd (mcd.m-2lx-1) Tapet i paster - RI = 259

Lageshtia e tapetit < 1%

Aplikimi

Boja përpara përdorimit duhet të përzihet mirë dhe kushtet atmosferike të jenë në një temperaturë mbi 5°C. Norma e harxhimit nga 2 kg./m² me spesor 1.500 micron deri 3 kg./m² spesor 2.000 micron.

Bojrat e përdorura nuk duhet të absorbojnë graso, vajra, njolla të asnjë tipi dhe të ketë një përberje kimike të përshtatshme që edhe në periudhën e mëpasme nuk duhet të ketë shenja të depërtimit të substancave bituminoze të shtresave asfaltike të rrugës. **Vijëzimi gjatë kohës së tharjes nuk duhet të shkelet nga automjetet.** Koeficienti i ashpersise (sipas R.R.R Anglez) nuk duhet të jete me pak se 60% e sipërfaqes se pa vijeuar.

Kontraktori duhet të dorëzojë një sasi prej 1 kg bojë nga e cila do të përdoret bashku me specifikimet teknike të fabrikës dhe normat e konsumimit dhe garancinë e jetëgjatësisë së vijës së shënuar. Ngjyra duhet të jete ngjyre e bardhe (ose e verdhe) puro. Ngjyra pas aplikimit duhet të rezistojë kohës. (e that, lagësht dhe me shi)

Në të gjitha rastet kur nevojitet, kontraktori duhet të sigurojë heqjen e shenjave të vjetra (vijave), sikurse çngjitjen dhe pastrimin e sipërfaqes nga elementë, të cilat dëmtojnë ose nuk kanë kapacitetin dhe komabilitetin për të mbajtur materialin që do aplikohet.

Punëdhënesi rezervon të drejtën për të provuar një kampion nga partia e bojës që është në përdorim në çdo moment.

Të gjitha materialet për krakteristikat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe me konfirmim nga përkthyesi dhe të noterizuara.

OBJEKTI:

A . Vizime rrugesh T=12cm me boje bikomponente
1. Ngjyre blu Rr.Donald Tamp ml=1636,
2. Rr.Berisha ml=2836,Rr.Skenderbeu ml=2181
3. Rr.Bulevardi Blu ml=2400
4. Vizimi Njesise per Institucionin Njesia Administrative Paskuqan

-) **Gjatesi e rruges Ltot. = 55001 ml ne te dy anet zone per parkim**
-) **Tabela Rrugore 183 cope**
-) **Do te kete disa Rruge me 3 Vizime dhe ca Rrugë me 1 vize ne mes**
-) **Do te kete edhe kalime kembesore 1700 m2**
-)

Ne zgjidhjen e projektit jane pasur parasysh:

- a) Zgjidhja ne anen Planimetrike te Rruges .
- b) Zgjidhja ne anen altimetrike te Rruges .
- c) Elementet sociale te rruges.

1. Zgjidhja Planimetrike

Ne zgjidhjen planimetrike eshte pasur parasysh asfaltimi i rruges te behet ne te dy anet e aksit te rruges ekzistuese dhe te lihen hapësirat e nevojshme per zhvillimin ne te ardhmen te infrastruktures nentokesore.

Ne kryqezime eshte bere rakordimi i kthesave me rreze te tille qe lejon kthimin normal te mjeteve.

2. Zgjidhja Altimetrike.

Nga ana altimetrike relievi faktik ne drejtimin gjatesor ka nje pjerresi te relativisht te madhe nga jugu ne veri dhe nga lindja ne perendim. Meqe objekti i ri do te ndertohet mbi nje rruge ekzistuese e cila ka nivelete te çrregullt, do te synohet ne krijimin e nje nivelete me pjerresi te lehte e uniforme.

3. Profili Gjatesor.

Profili gjatesor perfaqeson prerjen e rruges sipas aksit te saj ne drejtimin vertikal. Profili gjatesor eshte hartuar ne shkalle vertikale 1:100 dhe ne shkalle horizontale 1:1000.

Ne te jane paraqitur:

- Vija e Terrenit
- Vija e Projektit
- Disnivelet e Vijes se Projektit
- Numri i Piketes (Seksionit)
- Kuota e Terrenit
- Kuota e Projektit
- Distanca Pjesore
- Distanca Progressive

4. Profilat Gjatesore dhe Profili Tip i Parmimit

Profilat terthore perfaqesojne prerje te rruges terthor me aksin e saj ne drejtimin vertikal.

5. Profilat Terthore.

Ne profilat tip jane paraqitur ne menyre te detajuar ne shkalle 1:50

- Shtresat rrugore
- Dimensionet e tyre
- Vendorsja e tyre
- Distanca
- Zona ku aplikohet profili tip

6. Zgjidhja sociale.

Duke pasur parasysh qe kjo zone eshte ne zhvillim e siper eshte pasur parasysh qe kjo rruge te behet me parametra qe t'i pershtaten zhvillimit te zones dhe hyrje daljet nga shtepite te kene lirshmeri.

7. Llogaritja e shtresave te rruges.

Nga studimi i gjendjes ekzistuese del qe asfaltimi do te behet ne te dy anet e aksit te rruges ekzistuese me pjerresi ne njerin krah.

4. PERMBAJTJA E PROJEKT - ZBATIMIT **PROJEKT - ZBATIMI PERMBAN KETO KAPITUJ**

KAPAKU I PROJEKTIT

FOTO TE OBJEKTIT

PLANIMETRIA EKZISTUESE

PLANIMTRIA E Rrugeve

PROFILAT tip

